



Pranuar / Dorezuar Punijena/Prodato Received/Delivery	17-10	2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Pislog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKIMSHUK	6558/2023		1/4	



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.447/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca, kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi, dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Rushit Kajtazi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, duke vepruar sipas Aktgjykimit A.nr.1846/2021 të datës 27.07.2023 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative ka shqyrtuar ankesën A.nr.447/2021 të datës 26.05.2021 të parashtruar nga ankuesit:

të cilët me autorizim i përfaqëson Shoqëria e Avokatëve kundër organit të punësimit Agjencia e Kosovës për Forenzikë, në çështjen juridike "Kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 17.10.2023, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa A.nr.447/2021 e datës 26.05.2021 e parashtruar nga ankuesit

A r s y e t i m

(me tutje referuar ankuesit) më datë 26.05.2021, përmes përfaqësuesit të autorizuar, respektivisht Shoqërisë së Avokatëve RPHS-LLC kanë parashtruar ankesë me numër protokollit 2628/2021 të regjistruar nën shenjen A.nr.447/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër heshtjes administrative të institucionit punëdhënës lidhur me kërkesën e tyre të datës 01.03.2021 me pretendimin ankimor që organi i punësimit të përmbush detyrimin e pagesës së mjeteve monetare ndaj ankuesve sipas Vendimit me numër Ref:43/2014 të datës 07.04.2014 për aprovimin e listës së pozitive dhe zyrtareve të përfshirë në Skemën e Fondit për Kuadro.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në mungesë të kuorumit për vendosje, me datë 07.07.2021, përmes shkresës me numër protokollit 4531/2021 ka njoftuar ankuesit lidhur me



rrethanat e krijuara e të cilat kanë pamundësuar shqyrtimin e ankesës A.nr.447/2021 të datës 26.05.2021 dhe të njëjtit i ka udhëzuar për ushtrimin e mjeteve juridike në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative. Kjo e fundit, me Aktgjykimin A.nr.1846/2021 të datës 27.07.2023 ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësve, ka anuluar Njoftimin e datës 07.07.2021 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe ka obliguar Këshillin që të shqyrtoj dhe të vendos për ankesën A.nr.447/2021 të datës 26.05.2021.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (Kolegji i Këshillit)* administroi këto prova: Ankesën A.nr.447/2021 të datës 26.05.2021; Njoftimin me numër protokoll 4531/2021 të datës 07.07.2021; Kërkesën e datës 10.05.2016; Aktgjykimin A.nr.1846/2021 të datës 27.07.2023 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative; Vendimin e datës 07.04.2014; Kontratën e punës të datës 22.07.2013 për Vendimin me numër protokoll AKF/2016 të datës 10.02.2016; Kontratën e punës të datës 22.07.2013, për Vendimin me numër protokoll AKF/2016-044 të datës 10.02.2016; Kontratën e punës të datës 22.07.2013 për Vendimin me numër protokoll AKF/2016-032 të datës 10.02.2016; Padinë e datës 16.08.2021, drejtuar Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative; Përgjigje në ankesë me numër protokoll 3019/2021 të datës 11.06.2021; E-mailin e datës 09.10.2023; E-mailin e datës 13.10.2023 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të MPB-së.

Kolegji i Këshillit duke ju referuar Aktgjykimit A.nr.1846/2021 të datës 27.07.2023 të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë konstatoi se ankesa e ankuesve është e pa bazuar, *sepse:*

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesi sipas Vendimit Nr. prot: AKF/2016-032 të datës 10.02.2016, mbanë pozitën e punës Udhëheqës i Divizionit (Labororit) për Ekzaminim të Kompjuterëve (Specialist i Lartë Mbikëqyrës) pranë Departamentit për Teknologji Informative Forenzike; ankuesja sipas Vendimit Nr. prot: AKF/2016-035 të datës 10.02.2016 mbanë pozitën e punës Udhëheqëse e Divizionit (Labororit) për Analiza Kimike të Narkotikëve (Specialiste e Lartë Mbikëqyrëse) pranë Departamentit për Kimi dhe Biologji Forenzike, ndërsa ankuesi sipas Vendimit Nr. prot: AKF/2016-044 të datës 10.02.2016, mbanë pozitën e punës Specialistë i Lartë në Divizionin (Labororin) e Dokumenteve dhe Dorëshkrimeve pranë Departamentit për Traseologji Forenzike.

Kolegji i Këshillit po ashtu nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se Komisioni i Fondit për Kuadro, i kryesuar nga Ministri i Ministrisë së Administratës Publike, duke u bazuar në Rregulloren Nr.14/2012 për Funkcionimin e Fondit për Kuadro, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr.03/2014, me datë 07.04.2014 ka nxjerr Vendimin me numër Ref:43/2014 me të cilin ka aprovuar listën e pozitave dhe të zyrtareve të Ministrisë së Punëve të Brendshme të cilët përfitojnë nga Skema e Fondit për Kuadro. Rrjedhimisht, me Vendimin me numër Ref:43/2014 të datës 07.04.2014 është përcaktuar specifikisht se nëpunësi dhe nëpunësja përfitojnë nga 250 euro në muaj, ndërsa nëpunësi sipas të njëjtit vendim është përcaktuar që të përfitoj 200 euro në muaj nga Skema e Fondit për Kuadro. Në kontekst të kësaj çështje, Njësia e Burimeve Njerëzore e MPB-së, përmes e-mailit zyrtar të datës 16.06.2016, e konfirmon se me Vendimin me numër Ref:43/2014 të datës 07.04.2014 janë të përfshirë dymbëdhjetë zyrtarë të MPB-së si përfitues të Fondit për Kuadro, ku nëntë prej tyre kanë realizuar shtesën nga ky Fond, ndërsa tre zyrtarë të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë, gjegjësisht ankuesit

edhe pse ishin të përfshirë në Skemën e Fondit për Kuadro sipas





këtij vendimi të njëjtit nuk e kanë realizuar asnjëherë të drejtën e tyre për shtesë nga ky Fond, deri sa Njësia për Buxhet dhe Financa e MPB-së e konfirmon faktin se buxheti në vitin 2014 është alokuar nga MF për Fondin për Kuadro në AKF në masën monetare prej 6,300.00 euro dhe është ndryshuar plani i rrjedhës se parasë që të mund ti kryhet pagesa këtyre zyrtareve.

Ankuesit, në lidhje me realizimin e mjeteve monetare në emër të shtesës nga Skema e Fondit për Kuadro, me datë 01.03.2021 kishin parashtruar kërkesë pranë organit punëdhënës, ndërsa për shkak të heshtjes administrative, të njëjtit, me datë 26.05.2021 i janë drejtuar me ankesë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor që organi i punësimit të përmbush detyrimin e pagesës se mjeteve monetare ndaj ankuesve, në mënyrë retroaktive, sipas Vendimit me numër Ref:43/2014 të datës 07.04.2014.

Kolegji i Këshillit, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesve ju referua nenit 15 paragrafi 1 të Rregullores Nr.14/2012 për Funkcionimin e Fondit për Kuadro, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr.03/2014, dhe si rrjedhojë konstatoi se Skema e Fondit për Kuadro ndërlidhej me ndarjen buxhetore vjetore sipas Ligjit për buxhetin dhe ishte Skemë e përkohshme, nga rrjedh se edhe Vendimi me numër Ref:43/2014 i datës 07.04.2014 me të cilin ishte përcaktuar që ankuesit të jenë përfitues të shtesës nga ky fond ishte i karakterit të përkohshëm dhe ndërlidhej me ndarjen buxhetore të vitit 2014, konstatim ky i mbështetur edhe në shkresën zyrtare (e-mailin) të datës 13.10.2023 të Njesisë se Burimeve Njerëzore të MPB-së, ku theksohet se organi përkatës i punësimit pas përfundimit të vitit përkatës buxhetor ka ndërprerë pagesat për këto fonde.

Andaj, duke qenë se Vendimi me numër Ref:43/2014 i datës 07.04.2014, në kuptim të dispozitave të Rregullores Nr.14/2012 për Funkcionimin e Fondit për Kuadro kishte efekt juridik të përkohshëm dhe atë vetëm për vitin buxhetor 2014, Kolegji i Këshillit në kontekst të pretendimit ankimor të ankuesve për kompensimin e mjeteve monetare në mënyrë retroaktive, ju referua po ashtu dispozitave të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, përkatësisht nenin 2 paragrafi 1 dhe 2 ku përcaktohet se: *1. Dispozitat e këtij ligji zbatohen për të punësuarit dhe punëdhënësit e sektorit privat dhe publik në Republikën e Kosovës. 2. Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për të punësuarit dhe punëdhënësit, punësimi i të cilëve rregullohet me ligj të veçantë, nëse ligji i veçantë nuk parashikon zgjidhje për çështje të caktuara nga marrëdhënia e punës"* dhe nenit 87 të të njëjtit ligj ku përcaktohet se: *Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës, dhe për pasojë konstatoi se kërkesa e ankuesve për realizimin e mjeteve monetare në mënyrë retroaktive sipas Vendimit me numër Ref:43/2014 të datës 07.04.2014, është e pa bazuar ngase sipas shkresave të lëndës rezulton se ankuesve ju kishte lindur e drejta në shtesë nga Skema e Fondit për Kuadro, me datë 07.04.2014, kur edhe ishte miratuar Vendimi me numër Ref:43/2014, ndërsa të njëjtit për realizimin e kësaj shtese kanë parashtruar kërkesë të organi punëdhënës me datë 01.03.2021 duke vazhduar kështu kundër heshtjes administrative me mjete juridike ankimore me datë 26.05.2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga rrjedh se kërkesa e ankuesve e parashtruar pranë organit punëdhënës me datë 01.03.2021 është parashkruar në kuptim të nenit 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, për faktin se e njëjta kërkesë ishte me e vjetër se tre (3) vite nga lindja e të drejtës, gjegjësisht nga momenti i hyrjes në fuqi të Vendimit me numër Ref:43/2014 të datës 07.04.2014.*

Kështu që për sa me sipër Kolegji i Këshillit konstatoi se ankesa e datës 26.05.2021 e parashtruar nga ankuesit përmes përfaqësuesit të autorizuar, gjegjësisht Shoqërisë së Avokatëve është e pabazuar për shkak se kërkesa e tyre e datës 01.03.2021 është e parashkruar, andaj mbi këtë bazë e






duke u mbështetur në dispozitat e nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenit 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi për refuzimin e të njëjtës, si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
**Lënda A.nr.447/2021**

**Rushit KAJTAZI**  
  
Procesmbajtës



**Vendimi i dërgohet:**

- Përfaqësuesit të ankuesve,
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë e Kosovës për Forenzikë;
- Arkivit të KPMSHCK-së

